



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:271633
Datë: 21.10.2024
Numri i dokumentit: 06327085

K.DH.SH.II.nr.715/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare kolegjit, Dren Rogova dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Kulla” O.P, me seli në fsh. Korishë, Komuna e Prizrenit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Esat Gutaj nga Prizreni, kundër të paditurës Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.518/23 të datës 25.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.10.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale e datës 16.02.2024, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.518/23 i datës 25.01.2024, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Me Aktgjykimin e ankimuar KA.nr.518/23 të datës 25.01.2024, nën pikën I të dispozitivit është vendosur, Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpapia e paditësit “Kulla” O.P. nën pikën II. Anulohet Aktvendimi nr.prot 4483 i datës 08.08.2011 dhe aktvendimi nr.prot 1939 i datës 20.06.2018 të nxjerra nga i padituri Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale si i kundërligjshëm. Nën pikën III. Ky aktgjykim i zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter detyrues. Nën pikën IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar e paditura, me të cilën në tërësi e kundërshton aktgjykimin e ankimuar për shkak të: shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës administrative dhe vërtetimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që aktgjykimin i atakuar i Dhomës së Shkallës së Parë të priset dhe çështja ti kthehet po kësaj gjykate në rishqyrtim dhe rivendosje apo të aprovohet ankesa e KPMM-së.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimin të kontestuar në drejtim të thënieve në ankesë, përgjigjes në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës në kuptim të nenit 44, par. 1 dhe 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), dhe neni 194 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK), i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, gjen se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me aktvendimin nr.1939 të datës 20.06.2018, ka refuzuar ankesën me nr.5511 të datës 08.09.2011 të parashtruar nga ndërmarrja NPT “Kulla”, me pronar Shkelzen Kabashi me nr. biznesi 70365068 me adresë fshati Korishë KK-Prizren. Nën pikën 1. Mbetet i plotëfuqishëm vendimi me nr.5511 i datës 08.09.2011 në shumën prej 5,000.00€ për aktivitet ilegal pa posedim të lejes së aktivitetit të veçantë-Bazë Betonit në bazë të nenit 79 par.4 të Ligjit me nr.03/L-163 për Miniera dhe Minerale. Ndërsa me vendimin nr.4483 të datës 08.08.2011 është vendosur, ndaj Shkelzen Kabashi pronar i Kompanisë N.P.T. “Kulla” me numër të biznesit 70365068 nga fshati Korishë, Komuna e Prizrenit. Në pikën 1. Në pajtim me nenin 79 paragrafi 4 shqiptohet gjoha administrative për zhvillimin e aktivitetit pa lejen për aktivitete të veçanta-bazë Betoni në shumë prej 5.000.00€.

Kundër këtij aktvendimi paditësi, ka hapur konflikt administrativ me padi në gjykatë. Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit publik dhe administrimit të provave relevante, si në procesverbalin e seancës për shqyrtim kryesor, në praninë e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, me aktgjykimin e aprovon kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar. Me arsyetim se Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 84 të Ligjit nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale i cili përcakton se: *“Çdo vendim apo veprim i KPMM-së, Ministrisë ose cilitdo Autoritet tjetër publik i cili është marrë në bazë të autorizimit të këtij ligji i nënshtrohet edhe shqyrtimit administrativ dhe atij gjyqësor si dhe ankesës, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parapara në Ligjin për Procedurën Administrative.”* dhe në kuptim të nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton se: *“Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative”*. Gjykata e shkallës së parë i vlerësoi të bazuara pretendimet e paditësit sepse të njëjtat kanë mbështetje në gjendjen faktike të vërtetuar nga i padituri në procedurë administrative, janë në përputhje me provat e administruara në këtë çështje dhe dispozitat ligjore materiale që rregullojnë këtë çështje. Gjykata po ashtu vlerësoi faktin se paditësi është pajisur me leje mjedisore komunale me datë 13.05.2019, por konsideroi se mungesa e lejes mjedisore komunale nuk e bënë të ligjshëm vendimin e të paditurit për shqiptimin e gjobës ndaj paditësit për mungesën e Lejes për Aktivitete të Veçanta pasi që përgjegjëse dhe me kompetencë për inspektimin lidhur me këto leje janë dy organe të ndryshme publike, andaj gjykata e vlerësoi si të pabazuar pretendimin e të paditurit në përgjigje në padi se paditësi ka ushtruar veprimtari ilegale për shkak se nuk ka poseduar leje as nga KPMM dhe as nga ndonjë institucion tjetër për prodhimin dhe përpunimin e betonit. Andaj, gjykata vlerëson se Inspektorati i MMPH-së, si institucion përgjegjës për mbikëqyrjen e veprimtarisë së paditësit ka bërë inspektim me datë 18.04.2019 dhe të njëjtin e ka udhëzuar që brenda 30 ditëve të aplikoj për tu pajisur me Leje Mjedisore Komunale, por nuk e ka vlerësuar të nevojshme shqiptimin gjobës. Gjithashtu, nga provat e administruara në këtë çështje, gjykata nuk gjeti asnjë provë e cila dëshmon se paditësi ka tejkalluar ndonjë kapacitet të kufizuar të prodhimit, madje nga prova procesverbal mbi inspektimin e kryer nr. 00010 i datës 18.04.2019 i hartuar nga Inspektorati i MMPH-së, është konstatuar se paditësi bënë

prodhimin e betonit në kapacitet deri në 5 m³ në ditë për prodhimin e elementeve të betonit, ndërsa më vonë përmes UA nr. 10/2012 për LMK kapaciteti i prodhimit është përcaktuar deri në 50m³. Gjykata vlerësoi udhëzimet e dhëna nga Dhoma e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale lidhur me sqarimin nëse veprimtaria e paditësit hynë në kategorinë e aktiviteteve të veçanta dhe sqarimin nëse Udhëzimi Administrativ nr. 10/2012 për Dhënien e Lejes Mjedisore Komunale dhe Udhëzimi Administrativ nr. 17/2015 për dhënien e lejes mjedisore komunale ndërlidhen apo përjashtojnë dispozitat e Ligjit për Minierat dhe Minerale dhe për të njëjtat gjykata e shkallës së parë vlerëson se nga provat e administruara në këtë çështje është vërtetuar se paditësi nuk zhvillon aktivitetin e hulumtimit, shfrytëzimit dhe / ose pasurimit të lëndëve minerale andaj gjykata vlerëson se veprimtaria e paditësit nuk rregullohet me Ligjin për Miniera dhe Minerale rrjedhimisht nuk hyn fare në kuadër të kompetencave për monitorim nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale. Lidhur me këtë, gjykata vlerëson se Udhëzimi Administrativ nr. 10/2012 për Dhënien e Lejes Mjedisore Komunale dhe Udhëzimi Administrativ nr. 17/2015 për dhënien e lejes mjedisore komunale janë akte nënligjore që burojnë nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit dhe duhet qenë se paditësi ushtron veprimtari që bie në kuadër të rregullimit ligjor të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, të njëjtat udhëzime administrative janë të aplikueshme në këtë rast. Duke qenë se gjykata në këtë rast vlerësoi se i padituri nuk ka pasur kompetencë për ushtrimin e mbikëqyrjes, përkatësisht shqiptimit të gjobës ndaj paditësit, gjykata shqyrtoi këtë çështje në juridiksion të plotë dhe anuloi vendimin për shqiptimin e gjobës dhe vendimin me të cilin është refuzuar ankesa e paditësit në procedurë administrative. Prandaj, gjykata përfundimisht vlerëson se i padituri me vendimin e kontestuar nga paditësi, ka vepruar në kundërshtim me 86 të LPA-së si dhe në kundërshtim me nenin 32 të Ligjit nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, andaj gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ndërsa për pikën II dhe III vendosi mbështetur në nenin 12 dhe 46 par. 3 dhe 4 të LKA-së.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Dhoma e Shkallës së Parë duke vlerësuar ligjshmërinë e

aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë iu ka referuar Ligji Nr. 03/L-163, për Minierat dhe Mineralet përkatësisht nenit 84 i cili përcakton se: “Çdo vendim apo veprim i KPMM-së Ministrisë ose cilido autoritet tjetër publik i cili është marrë në bazë të autorizimit të këtij ligji i nënshtrohet edhe shqyrtimi administrativ dhe atij gjyqësor si dhe ankesës, në përputhje me kushtet dhe Procedurat e paraparë në Ligjin për Procedurën Administrative” dhe në kuptim të nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton se “ gjykata në konflikt administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative me të cilat organet e administratës në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizik dhe juridik në çështjet administrative”. Andaj, Kolegji vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë drejtë ka konstatuar se pretendimet e paditësit janë të bazuara sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e të paditurës në procedurë administrative dhe në kundërshtim me provat e administruara në këtë çështje, pasi që vendimi i të paditurës nuk është në përputhje me nenin 1 dhe 2 par.1 lidhur me nenin 3 par.1 nën par 1.49 të Ligjit nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale si dhe me nenin 32 të Ligjit nr. 03/L-025 për mbrojtjen e Mjedisit, pasi që ky vendim është mbështetur në dispozita ligjore të cilat nuk janë të aplikueshme në rastin konkret, dhe gjendjes faktike të konstatuar me rastin e inspektimit tek paditësi.

Në raport me pretendimet ankimore se aktgjykimi i ankimuar është në kundërshtim me Ligjin për Minierat dhe Mineralet dhe nuk qëndron interpretimi i gjykatës se në momentin që ndërmarrja pajiset me leje Mjedisore komunale dhe apo leje mjedisore nga MMPHI nuk ka obligim të pajiset me leje për aktivitet të veçantë-bazë betoni. Leja mjedisore nga MMPHI dhe Leja Mjedisore Komunale nga MMPHI janë kritere apo kushte pa të cilat nuk mund të merret leja për aktivitet të veçantë-bazë betoni. Pra pëlqimi mjedisor dhe leja mjedisore janë kusht për pajisje të lëshuara nga MMPH dhe çfarëdo miratime tjera nga aktivitete tjera publike të cilat kërkohen sipas Ligjit në Kosovë. Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë vlerëson së Dhoma e Shkallës së Parë me të drejtë ka konstatuar se Udhëzimi Administrativ nr. 10/2012 për Dhënien e Lejes Mjedisore Komunale dhe Udhëzimi Administrativ nr. 17/2015 për dhënien e lejes mjedisore komunale janë akte nënligjore që burojnë nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit dhe duke qenë se paditësi ushtron veprimtari që bie në kuadër të rregullimit ligjor të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, të

njëjtat udhëzime administrative janë të aplikueshme në këtë rast. Kolegji ka vlerësuar se nga provat e administruara në këtë çështje shihet qartë se paditësi nuk zhvillon aktivitetin e hulumtimit, shfrytëzimit ose pasurimit të lëndëve minerale andaj, veprimtaria e paditësit nuk rregullohet me Ligjin për Miniera dhe Minerale dhe nuk hyn fare në kuadër të kompetencave për monitorim nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale. Duke qenë se kolegji në këtë rast vlerësoi se i padituri nuk ka pasur kompetencë për ushtrimin e mbikëqyrjes, përkatësisht shqiptimit të gjobës ndaj paditësit, gjykata shqyrtoi këtë çështje në juridiksion të plotë dhe anuloi vendimin për shqiptimin e gjobës dhe vendimin me të cilin është refuzuar ankesa e paditësit në procedurë administrative.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht vlerësoi vendimet e të paditurës dhe po ashtu gabimisht aplikoi edhe të drejtën materiale në dëm të palës së paditur kur mori vendim mbi aprovimin e padisë dhe anulimin e vendimit andaj me këtë rast gjykata ka bërë edhe shkeljen thelbësore të dispozitave të procedurës administrative. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate i refuzon si të pa bazuara pasi që nga shkresat e lëndës kolegji gjeti se në bazë të procesverbalit mbi inspektimit të kryer të datës 18.04.2019 në Prizren nuk figuron se paditësi ka zhvilluar aktivitete të veçanta për arsye, se në konstatimin e procesverbalit të cekur më lartë është dhënë konstatim se operatori nuk është në proces të punës, pastaj ka dhënë konstatime tjera se në pllacë gjendet makineria për prodhim me elemente të betonit, pra nuk ka asnjë konstatim se paditësi gjatë këtij kontrolli ka qenë duke zhvilluar aktivitetin –për të cilën kërkohet leja e veçant nga nenin 1.49 të Ligjit 03/L-163. Andaj, Dhoma e Shkallës së Parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore. Kështu për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale, dhe Dhoma e Shkallës së Parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, se nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës, ngase paditësi me asnjë fakt të vetëm nuk e ka bërë të besueshëm se ankesa e tij është e bazuar. Duke marrë parasysh se Dhoma e Shkallës së Parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të padisë

së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mundë të vihet në pyetje, ankesa të paditurës u refuzua si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.81/24, me datë 21.10.2024

Kryetare e kolegjit,
Franciska Zhitija Ymeri